

GREEN COAST SH.P.K.

RRUGA "TISH DAIJA", KOMPLEKSI KIKA 2, GODINA 3, KATI 1., TIRANE, SHQIPËRI

L41329038D

VENDIM

I

ASAMBLEË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 26.12.2023, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **Green Coast Sh.p.k.** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- **Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrisë Tregtare me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 0342771384 (dhe me nr. Personal: I35203147R), madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (këtu e në vijim referuar si "**Ortaku i Vetëm**"),

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Z. Bers Hado, këshilltar ligjor i shoqërisë, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblesë të Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZMADHIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtron se kapitali aktual i Shoqërisë është 3,529,521,328 LEK (tre miliard e pesëqind e njetzet e nente milion e pesëqind e njëzetë e një mijë e treqind e njëzetë e tetë lekë).

Me qëllim zhvillimin e projekteve MGallery dhe Green Coast Village ka lindur nevoja e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë. Është vlerësuar e përshtatshme **zmadhimi I kapitalit me 480,212,000 LEK (Katër qind e tetëdhjetë e miljon e dyqind e dymbëdhjetë mijë e lekë)** të cilat do të shpërndahen përkatësisht sipas projekteve :

268,643,974 LEK (Dy qind e gjashtedhjetë e tete milion e gjashtëqind e dyzet e tremije e nenteqind e shtatedhjetë e kater lekë) per projektin MGallery Hotel

115,616,537 LEK (Njeqind e pesembedhjetë milion e gjashtëqind e gjashtembedhjetë e mijë e pesë qind e tridhjetë e shtate leke) për projektin Green Coast Village_ Nukli L,

75,316,790 LEK (shtatedhjetë e pese milion e treqind e gjashtembedhjetë mije e shtateqind e nentedhjetë lekë) per projektin Green Coast Village_ Nukli G15.

20,634,700 LEK (njetzet milion e gjashtëqind e tridhjetë e kater mije e shtateqind leke Leke) per projektin Green Coast Village Infrastruktura e përbashkët.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja

VENDOS:

- A. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën 480,212,000 LEK (Katër qind e tetëdhjetë e mijon e dyqind e dymbëdhjetë mijë e lekë), vlerë e cila do të investohen përkatësisht sipas projekteve :
- vlerën 2,603,803 Euro per projektin MGallery
 - vlerën 1,120,601 Euro per projektin Green Coast Village_ Nukli L
 - vlerën 730,000 Euro per projektin Green Coast Village_ Nukli G15
 - vlerën 200,000 Euro per projektin Green Coast Village Infrastruktura e përbashkët
- B. Bazuar në sa më sipër zmadhimi i kapitalit do të konsiderohet Kontribut ne Para dhe i shlyer plotësisht nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.
- C. Si rezultat i miratimit të Zmadhimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga 3,529,521,328 LEK (tre miliard e pesëqind e njezet e nente milion e pesëqind e njëzetë e nje mijë e treqind e njëzetë e tetë lekë) do të bëhet 4,009,733,328 LEK (katër miliard e nente milion e shtateqind e tridhjetë e tre mijë e tre qind e njezet e tetë lekë).

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Green Coast" sh.p.k mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

**ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
GREEN COAST SH.P.K.**

KRYETARI



Znj. Edlira MUKA

SEKRETARI



Z. Bers Hado

